

KOSOVARJA

Ballina: Majlinda Sulejmani

Foto: Safer Aliqkaj

**Sa shqiptarë,
aq bajraktarë**

**Sa herë
më kujtohet
hyqmeti,
më rrëqethet
trupi**

**Halla ime
i kishte
10 fëmijë,
unë mezi 1**

***Majlinda Sulejmani
i ka të gjitha, nuk jeton
për epitete, famë e lavde***

**A ka
në Prishtinë
dashuri për
një natë**

**Në Kosovë
nusja
më e keqe
kushton
10 mijë euro**

**Nuk kam qenë
e rehatshme,
si të martohem tash**



remos

DENTFIX

HELPER
GENÈVE

SHERWOOD
Beauty and Health

MARITIM
Beauty and Health

allure
PARIS

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj
FISH RESTAURANT

MOLLA

Shkenda Dybena
Desserts and Pastries

Banaderm

BREZOVICA
HOTEL & SPA

CIMA
CASA DI MONTENAPOLEONE



**MAGJISTRALJA PRISHTINË - FERIZAJ,
KONJUH 14000 LIPJAN**

+383 49 566 667 / WWW.DINO-COMPANY.COM

f DINO QERAMIKA



A ka politikanë që thotë s'dua të merrem më me politikë?

A ka politikanë që thotë - s'dua të merrem më me politikë? Kjo është një pyetje që duhet shtruar sot çdo politikan yni, i cili do të mendonte si ta ndryshojë shtetin. Prandaj, kemi nevojë për ndryshime urgjente që ta mbrojmë shtetin, për të cilin sakrifikuan mijëra shqiptarë, për Republikën e Kosovës...

Kishte hipur një njeri mbi degë lisi dhe po e prenë degën ku qëndronte ai vetë. Kalon aty pari Nastradin Hoxha dhe, posa e pa se po e prenë degën ku ai qëndronte vetë, i tha: "O njeri, do rrëzohesh se po e prenë degën ku ti rri vetë!". Drupterësi i tha: "Shiko ti punën tënde! A nuk ke me çka tjetër të merresh, por me mua, a?!". Nastradini vazhdoi rrugën, kurse ai bie nga lisi posa e prenë degën... Kur ra në tokë tha se kalimtari paska pas qenë profet dhe i sulet pas. Kur e arriti, i tha: "Ti qenke profet! Më trego kur do të vdes?".

"Nuk di kur do të vdesësh ti!". Ai nuk e lëshonte Nastradinin të ecte tutje pa i treguar. Dhe, kur Nastradini pa se ai nuk do e lëshojë dot, i tha: "Ti do të vdesësh kur të rrëzohet tërë lisi!". "E, si po e di?!", e pyeti. "Sepse, ai të shtypë dot!". Andaj, edhe pushtetarët tanë janë të tillë. Nuk dinë se po rrëzohen edhe kur e humbin pushtetin. Të tillët mendojnë se ende mund të del ndonjë gjë, helbete... Sepse, te ne ende nuk ka politikan që thotë: Boll më, nuk dua të merrem më me politikë!

S. M.

Së shpejti...



Alaudin Hamiti

Kush merr pjesë dhe sa paguhen pjesëmarrësit në “Big Brother Kosova”?

Gjithçka duket gati për nisjen e “Big Brother” në Kosovë, meqë janë siguruar të drejtat për territorin e Republikës së Kosovës me “Bani-jay Rights”.

Puna ka nisur si në aspektin teknik, ashtu edhe në atë përmbajtjesor dhe premiera e parë e spektaklit do të jetë në vjeshtë.

Por, kush do jenë personazhet e zgjedhur në Kosovë për këtë super emision të ndjekur?

Mirëpo, do zgjidhen emra nga të gjitha trevat, pra jo vetëm nga Kosova. Moderatorin e njohur kosovar, Alaudin Hamiti, është zgjedhur prezantuesi i këtij edicioni të parë të “Big Brother VIP Kosova”.

Përflitet se në këtë spektakël do të marrë pjesë këngëtari i njohur Robert Berisha.

Por, krahas Robertit, kush do të bëhet pjesë e këtij spektakli tashmë të njohur?



Elvana Gjata



Don Xhoni



Capital T



Luana Vjollca



Robert Berisha



Vildane Zeneli

Duket se kontratat janë mbyllur me një sërë emrash edhe nga Shqipëria. Përflitet se Noizy është një ndër emrat më të spikatur që ka pranuar ftesën për të marrë pjesë në këtë spektakël. Nga ana tjetër, ky format do të rikthejë në ekran edhe Luana Vjollcën, që do të jetë pjesë e shtëpisë, kundrejt një pagese të majme.

Me shumë interes është përcjellë edhe emri i Elvana Gjatës në këtë format, që është ndër personazhet më të dashura nga publiku ynë. Emrat e tjerë të përfolur janë edhe Alban Ramosaj, Vildane Zeneli, Don Xhoni, Adriola Dushi, Capital T dhe shumë emra të njohur nga trojet shqiptare dhe diaspora. E, çmimi që ata do të paguhen varion nga 5 mijë deri në 10 mijë euro, varësisht nga qëndrimi brenda.



Noizy



Pamje e Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari"

Kur Kosova do të mbetet në 700 mijë banorë?!

Ikja e kosovarëve nga vendi është kthyer në qendër të vëmendjes pas publikimit të të dhënave të fundit nga ASK-ja dhe "Eurostat"-i.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mbi 42 mijë qytetarë e kanë braktisur vjet Kosovën. Ish-Ministri i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni ka thënë se ky trend i ikjeve pritet të vazhdojë edhe viteve të ardhshme. Sipas tij, Kosova mund të bie nën 1 milion banorë në mandatin e Kurtit.

Situatën për të cilën më parë kritikonte e fajësonte partitë që ishin në pushtet, tash po e ndjen në lëkurën e tij edhe vetë kryeministri Albin Kurti.

Në një fjalim që e kishte mbajtur në Kuvend sa ishte në opozitë, Kurti thoshte se qytetarët po ikin nga kryeministri e Qeveria.

Po tash, nga kush po ikin?

Ditë më parë, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka publikuar raportin për "Vlerësimin e Popullsisë për vitin 2021", ku bëhet e ditur se vetëm vjet janë larguar mbi 42 mijë qytetarë.

Shumica e tyre kanë qenë emigrantë legalë dhe kanë emigruar në vende të

Bashkimit Evropian. Por, ka edhe të tjerë që kanë shkuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqi a Kanada.

Emigrimi legal ishte për shkak të bashkimit familjar, martesave, gjetja e një vendi pune, shpërnguljes së përhershme (kryesisht në shtetet fqinje), studime afatgjata me punësim etj.

E, se popullsia e Kosovës është tkurrur me kalimin e viteve, tregojnë edhe statistikat e "Eurostat"-it. Sipas këtyre të dhënave, popullsia e Kosovës është reduktuar me 10.2%, në krahasim me vitin 2003, kur raportohen për herë të parë të dhënat. Trendi i ikjes së qytetarëve nga vendi do të vazhdojë edhe viteve të ardhshme, sipas ish-ministrit të Punëve të Jashtme, Skender Hysenit, i cili ka deklaruar se ka parë edhe projeksione për këtë çështje. Hyseni ka thënë se Kosova rrezikon të bie nën 1 milion banorë deri në përfundimin e mandatit të kryeministrit Albin Kurti. "Deri në fund të mandatit të Kurtit, Kosova mund të bie nën 1 milionë banorë", ka

deklaruar ai.

Sipas tij, deri në vitin 2030, Kosova do të ketë 700 mijë banorë!

"E kam parë, së fundi, një raport të Bankës Botërore, që deri në vitin 2030 Kosova do të ketë 700 mijë banorë. Nuk e di në bazë të çfarë indikatorësh është ndërtuar ky projektion.

Sot Kosova nuk ka më shumë se 1 milion e 500 mijë banorë që jetojnë këtu. Në regjistrimin e fundit i ka pasur 1 milion e 800 mijë gjithsej", ka thënë ai.

SI TA PËRMBYLLIM KËTË SHKRIM?

Sidoqoftë, një gjë dihet, çdo vit numri i njerëzve që e lënë Kosovën është i madh, pavarësisht deklaratave të politikanëve tanë se do krijojnë kushte për jetë më të mirë në Kosovë, se do të krijojnë vende për shkollim e studime, se do të krijojnë vende të reja pune, se Kosovën do e bëjnë Zvicër, e të tjera të ngjashme...

Selim Rama

SA SHQIPTARË, AQ BAJRAKTARË!



Ky shkrim mund të mos nënshkruhet me emrin tim. Janë fjalë të nxjerra nga shkrimet, mendimet e të tjerëve. I nxora me qëllim fjalë të thëna edhe para njëqind vitesh, por që vlejnë edhe sot të përmenden, të rikujtohen...

Kush ishim, ku jemi, kah po shkojmë?

Pyetje këto i dëgjon jo rrallë në muhabetet tona, në dialogët me njëri-tjetrin.

Ne i kemi shkruar me gjakun tonë mjaft faqe të historisë jo vetëm të Evropës... Vlen të përmendim faktin se shqiptarët i kanë dhënë Turqisë hiç më pak se 35 kryeministra në katër shekuj e gjysmë dhe një numër të madh komandantësh ushtrie e diplomatësh.

Shqipëria i ka dhënë edhe një mbret Egjiptit dhe jo vetëm këtë.

Një gjë e tillë e shqiptarëve në shtetet e huaja ka qenë gati përherë dhe vazhdon të jetë edhe sot. Sa shqiptari është nëpër botë që kontribuon në sfera të ndryshme të jetës?!

Nuk janë të paktë ata shqiptarë që i njeh bota...

Për shqiptarët janë shkruar faqe e faqe, jo vetëm nga studiuesit e ndryshëm ndërkom-bëtar, por edhe nga të shumtë gjeneralë e politikanë të shteteve të ndryshme të botës.

Lord Bajroni shkruante: "Shqiptarët me kostumet e tyre bëjnë një peizazh më të mrekullueshëm në botë... Shqiptarët janë raca njerëzore më e bukura që ekziston, trima më të

fortë se kështjellat e tyre..."

"Shqiptarët janë banorë më të vjetër të Gadishullit Ballkanik, gjegjësisht të racës ariane, duke nxjerr këtë fjalë nga dy rrënjët e fjalëve shqipe: ar dhe anë, që d. m. th., njerëz të arit të pastër", shkruan Edvin Pears.

Për karakterin e tiparet tona ishim të veçantë dhe na lakmonte shumëkush. U bëmë ballë të gjitha sulmeve shekullore, nga sulmet e romanëve, nga Perandoria Otomane, sulmet e sllavëve, të cilat na tkurrën e na lanë të shpërndarë në pesë copë jashtë atdheut. Janë munduar të na e zhdukin prej faqes së dheut dhe emrin shqiptar. Hiç më pak se 600 vjet okupimesh. Dhe, s'arritën të na zhdukin, mbetëm këta që jemi sot...

Por, e keqja edhe sot vlen thënia e të madhit Konica se armiku i shqiptarit është shqiptari.

Apo edhe fjalët e Ali Pashës: "Unë jam mbret i dy milionë mbretërve".

Secili po është mbret për njëri-tjetrin.

Secili bajraktar.

Sot në paqe e në liri, përditë po zbehet nga një e mirë shqiptare, e karakterit, e tipareve, e virtyteve, madje edhe i kostumeve të identitetit tonë.

Dhe, vërtet, siç pyesin e thonë jo pak vetë sot:

Kush ishim, ku jemi, kah po shkojmë?

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Majlinda Sulejmani i ka të gjitha, nuk jeton për epitete, famë e lavde

Asaj nuk i duhen epitete klishe: “e mrekullueshme”, “e fortë”, “e guximshme”, “e jashtëzakonshme”. Majlinda Sulejmani i ka të gjitha dhe nuk jeton për epitete, për famë e lavde. Punon fuqishëm në disa drejtime, duke tentuar që gjithë potencialin e saj intelektual dhe njerëzor ta vë në shërbim të gjërave të mëdha e të mira. Është nga ato femra që sa e sheh këtu e sa atje, që nuk ndalen së punuari dhe se dita për të do të duhej të ishte më shumë se 24 orë.

Majlinda Sulejmani, shqiptarja e suksesshme e fushës së mjekësisë, politikës dhe me shpirt human, që nuk ndalon së qeni pranë atyre që kanë nevojë, shpalosë jetën e saj në “Kosovare”...



Majlindë, ju jeni një femër e zonja e me shumë të arritura. Por, si do ta prezantoje veten për ata që, ndoshta, nuk të njohin?

- Jam Majlinda Sulejmani, e njohur nga angazhimi im në fushën e politikës, humanizmit, shëndetësisë dhe artit. Jam modeste, tolerante, e hapur, direkte, por konsekuente në shumë gjëra që duhen të kenë respekt dhe transparencë.

Humanizmi dhe ndihma për të tjerët më karakterizojnë si person, meqë asnjëherë nuk ndalem së ndihmuari njerëzit, pa marrë parasysh se çfarë dhe kush janë.

Gjatë gjithë kohës jap ndihma të ndryshme, pa cekur fonde apo persona. Më dhemb shpirti kur dëgjoj që në shumë rajone të Kosovës ka varfëri të skajshme, andaj nuk mund ta ndalë zemrën dhe, normalisht, nuk hezitojë e i ndihmoj pa masë.

Jeni shqiptare e rritur në Diasporë, e shkolluar dhe e integruar në mënyrën më të mirë të mundshme. Fillimisht, na fol për shkollimin tënd?

- Jam e lindur në Gjilan, por kur isha vetëm pesë muajsh kishim pas kaluar në Zvicër, atje ku ishte babai im. Për mua ishte e vështirë ta kuptoja gjuhën gjermane deri në klasën e katërt, sepse në shtëpinë tonë flitej vetëm shqip dhe normalisht nuk isha e integruar.

Deri në klasën e katërt vetëm fjalën "A bën?" e kuptoja. Por, me vullnet dhe vendosmëri arrita të mësoj gjuhën gjermane, italiane, angleze, serbokroatishte, frënge, latinishten dhe normalisht shqipen.

Shkollën fillore dhe të mesme i kam kryer në Widnau dhe, pastaj, isha në studime të shkollës së mesme të mjekësisë.

Tutje, vazhdova edhe shkollimin si kontabiliste dhe ia dola me sukses. Pastaj, punova si teknike e mjekësisë në degën e emergjencës. Nuk u ndala këtu dhe vazhdova shkollimin, duke u bërë profesoreshë e shkollës së mjekësisë.

Më pas i fillova studimet e Menaxhmentit Shëndetësor në qytetin Saint Gallen, duke i përfunduar me notën më të lartë nivelet "Bachelor" dhe

"Master" në këtë drejtim.

Kam punuar si menaxhere e ambulancës, si zëvendëse e Qendrës së Psikiatrisë dhe për momentin mbaj postin e menaxheres në Klinikën Alternative.

A kishe pengesa, a ndërhynte familja sa i përket shkollimit, avancimit dhe kyçjes tënde në disa fusha njëkohësisht, apo ishin mbështetës?

- Pengesa nga familja nuk kisha, por ata donin që fokusin ta vendosja plotësisht në fushën e mjekësisë. E, meqë familjarisht jemi mjekë dhe mjeke, sigurisht që edhe për mua mjekësia ishte inspirim.

Ama, unë isha e fokusuar edhe në politikë dhe në punë humanitare. Kjo më ka përmbushur edhe më shumë dhe më ka bërë të studioja edhe më me pasion në fushën e mjekësisë.

A të kujtohet puna dhe angazhimi i parë dhe çfarë ndjesie ke sot kur e kujton?

- Në Klinikën Onkologjike e kisha një rast që edhe sot e kujtoj me lot e emocione. Ishte një pacient i moshës 21 vjeç, pra i moshës sime asaj kohe, i cili e kishte një sëmundje të pashërueshme, që më parë e kishte humbur edhe të ëmën nga e njëjta sëmundje.

Krijova miqësi dhe çdo mëngjes i bëja trajtim dhe ja dërgoja gazetën. Kur ndërroi jetë unë nuk isha aty dhe fjalët e fundit të tij kishin qenë rreth falënderimit ndaj meje dhe, gjithashtu, kishte kërkuar të merrja pjesë në varrimin e tij.

E kujtoj me shumë dhimbje, pasi ishim të një gjenerate, andaj më ka prekur emocionalisht.

Majlindë, a mund t'i marrim angazhimet tua me radhë?

- Për momentin jam menaxhere në Klinikën e njohur ndërkombëtarisht për mjekësinë biologjike-integrative në Zvicër.

Në bazë të njohurive dhe përvojës në mjekësinë konvencionale dhe plotësuese, klinika trajton, kryesisht, të gjitha llojet e sëmundjeve kronike dhe onkologjike. I udhëheq afro 50 punëtorë.

Puna ime e dytë është profesoreshë në Shkollën e Mjekësisë.

E, puna e tretë që bëj është këshilltare për persona me aftësi të kufizuara dhe përkthyes në disa institucione.

Po ashtu, kam firmën time personale "Majlinda Sulejmani Medical Consulting", që përben menaxhimin e ordinancave dhe kontabilitetin e ordinancave në Zvicër. Qëllimi i firmës sime është që t'i punësoj gratë dhe nënat vetushqyese nga Kosova dhe të jenë të pavarura.

Jam e lidhur me disa kompani, të cilave u udhëheq sektorin e marketingut.

E, sa i përket aspektit të humanizmit, jam në bordin menaxhues në "Fundjavë ndryshe Swiss".

Ju merreni edhe me politikë, a?

- Si 17-vjeçare i jam futur politikës. Fillimisht nuk e mora shumë seriozisht, pasi isha në shkollën e mjekësisë. Gjithsesi, politika sot zë vend në jetën time, pasi jam kryetare e partisë së mjedisit St. Margrethen, jam në komisionin e shëndetësisë dhe në kryesinë e Partisë së grave të kantonit tonë.

E ke menduar, ndonjëherë, inkudrimin në skenën politike në Kosovë?

- Kam pasur dhjetëra oferta nga shumë parti politike, por u kam thënë jo, pasi dua të mbetëm neutrale. Jam e hapur për konsulta, por nuk kam pretendime të jem pjesë e fushës së politikës shqiptare, apo të jem pjesë e Kuvendit të Kosovës.

A keni pasur rast t'u ndihmoni shqiptarëve në aspektin shëndetësor?

- Kam me qindra pacientë dhe klientë shqiptarë që më respektojnë shumë për punën, korrektësinë dhe shërbimin e mirëfilltë.

Siç thashë, jam tejet humane, dëshira ime është të ndihmoj, gjë të cilën për shqiptarët e bëj me zemër e shpirt. Dhe, lëre që ndihmoj për mjekësi, por në mënyrë vullnetare merrem me plotësimin e qindra formularëve, shkrimin e ankesave e kërkesave të shqiptarëve tanë etj.

Në çfarë gjendje e sheh mjekësinë në Kosovë?

- Nga Federata e mjekëve shqiptarë në Evropë, kryetare e së cilës është



mikja ime, Dr. Aurora Dollenberg, kam pasur rastin t'i njohë shumë mjekë dhe mjeke nga Kosova, të cilët më kanë habitur me talentin, aftësinë dhe horizontin që kanë pasur dhe kanë për të arritur në fushën e mjekësisë dhe në shkollim, në përgjithësi.

Për momentin, në Kosovë mungon digjitalizimi i shëndetësisë, infrastruktura, sigurimet, por që uroj të zgjidhen me kohë.

Është shumë e dhimbshme kur shoh që shumë mjekë po ikin nga Kosova.

Dua të inkuadrohem në disa projekte shëndetësore, që njohuritë e mia t'i shërbejnë konceptit të shëndetësisë së Kosovës.

Keni pasur edhe disa iniciativa humanitare. Mund të flasim për to?

- Për momentin jam në kryesinë e bordit "Fundjavë ndryshe Swiss". Gjithashtu, jam e inkuadruar në projektin e këpucëve ortopedike nga firma "Joya" në Zvicër, ku jam imazh i kampanjës publicitare dhe kam dashur që paga ime aty të shndërrohet në donacion për Kosovën, pra në sjelljen në vendin tonë të një kontingjenti këpucësh të tilla në spitalet e Gjilanit dhe Bujanocit, nga ku e kam prejardhjen.

Sepse, guri më së miri peshon në vend të vet...

Si është të jesh femër dhe të jesh kaq e përfshirë në disa drejtime dhe punë me mjaft përgjegjësi?

- Unë nuk mendoj se gjinia është përcaktuese e aftësive ose suksesit. Femrat duhet ta dinë që janë shumë të forta dhe mund t'i minimizojnë të gjitha paragjykimet eventuale. Për fat, më të mirë dhe më të fortë më bën edhe menaxhmenti im në Kosovë dhe Zvicër, që m'i menaxhojnë të gjitha terminët dhe nuk më lënë hapësira për jokorrektësi. Kur personalisht kryej punë të mëdha dhe me kaq përgjegjësi, jam mjaft e lumtur, dyfish më e lumtur që, ndër të tjerash, e tregoj forcën e femrës.

A mendon se do ta kishe këtë sukses edhe sikur të ishe në Kosovë?

- Thuaje çdo muaj udhëtoj për në Kosovë, por ajo që më pengon shumë këtu është jokorrektësia në orare. Gjithashtu, premtimet e rrejshme dhe korrupsioni i disa figurave politike në Kosovë është shqetësuese.

Jam tejet transparente, andaj nëse do të isha në Kosovë do të isha e tronditur nga disa gjëra të cilat ndodhin këtu.

Ndërkohë, pavarësisht se sa strikte janë punët tua, ti ke një reflektim tejet pozitiv për jetën dhe gjërat që të rrethojnë. Si ia del?

- Unë e shoh jetën me pozitivitet, pasi që çdo gjë që ndodh në jetë, ndodh për një arsye. Nëse diçka më ndodh papritmas, e kujtoj ditën në vijim që do të bëhet mirë.

Pse të nervozohem ose ta shoh jetën me negativitet?

Me rëndësi jam shëndosh e mirë. Të gjitha blihen, por lumturia dhe shëndeti janë pasuria më e madhe që nuk kanë çmim.

Kush ose çka të motivon në jetë?

- Në jetë më motivojnë, së pari, prindërit, që i kam ende në krahët e mi dhe bashkë me familjen time të ngushtë dhe të gjerë i gëzohen secilit sukses që kam.

Pastaj, pacientët që vijnë me dhimbje dhe dalin të buzëqeshur nga mjekimi im.

Kur e sheh veten në pasqyrë, cili është mendimi i parë që të vjen në mend?

- Se edhe sakrificat që i pata në jetë më bënë më të fortë, më bënë të jem kjo që jam sot. Beso në veten, reflekto sinqeritetin tënd pozitiv!

A ka mbetur diçka pa u thënë?

- Ëndrra ime nga fëmijëria ka qenë të isha pjesë e revistës prestigjioze "Kosovarja" dhe ja ku jam, për të folur për sukseset e mia... Faleminderit dhe mbarësi juve!

Nderim Neziri



**Majlinda
Sulejmani**

Nga xhelozia apo...

Telefoni celular, kudo në botë, e veçmas te ne shqiptarët, është mollë sherri i të dashuruarve. Shtrohet pyetja: A mund t'i ruajmë fshehtësitë që i përmban telefoni celular nga njerëzit kureshtarë që kemi përreth? Ka njerëz që me pa durim presin të zbulojnë ndonjë porosi që gjendet në telefonin tuaj. Më së shpeshti atë e bëjnë të dashuruarit. Andaj, ja se ç'thonë të anketuarit tanë për këtë...

ARVANITA:
NUK DUA TELEFONIN T'MA KONTROLLOJ AS I DASHURI!

- Nëse dikush ma kontrollon telefonin tim, kjo gjë më pengon, madje shumë. Por, kjo varet edhe nga ajo se kush ma kontrollon telefonin. Bie fjala, nëse këtë gjë e bën i dashuri im, pa dyshim, ndihem keq, sepse ka raste kur e ruaj ndonjë mesazh nga ndonjë shok a shoqe dhe mund të keqkuptohet. Megjithatë, e kam shprehur të keqe dhe shpesh të dashurit tim ia kontrolloj telefonin dhe m'u për këtë një ditë edhe patëm një zënkë bukur të madhe...

ASDRENI:
I TREGOJ GJITHÇKA TË DASHURËS SIME...

- Më pengon shumë kur kushdo qoftë ma kontrollon telefonin, e sidomos e dashura ime, e cila tash është në vitin e dytë të studimeve në psikologji. Kur ma kontrollon telefonin ndihem sikur nuk ka besim në mua, sikur ka mësuar a dëgjuar për ndonjë thashetheme. E unë jam ai që i tregoj për gjithçka, sepse nuk jam prej atyre që merren me dashuriçka. E kam gjetur një që e dua dhe më pëlqen, andaj edhe nuk dua të vrapoj pas të tjerave...



Pse të dashurit ia kontrollojmë telefonin?

ERLETA:
E KAM ZËNË DUKE MË MASHTRUAR!

- Jam motër medicinale, kurse i dashuri im punon në njërin nga ministritë tona. Një ditë, teksa pinim kafe bashkë, ai shkoi në tualet, e unë mbeta për pak çaste vetëm në tavolinën tonë. Mbi tavolinë ishte edhe telefoni i tij. Kur do Zoti për të keq, në ato çaste telefoni i tij cingëroi. Ishte një mesazh. U nervozova shumë, sepse nuk e dija nga kush i erdhi. Nuk e hapa. Kur erdhi e u ul, i thashë se pak më parë të erdhi një mesazh.

E hapi, e lexoi dhe e mbylli telefonin sikur s'kishte asgjë me rëndësi në të, krejt i qetë. Por, teksa rrinim, drejt më hipi në kokë dhe vend vetes nuk i zija. Kush do ia ketë dërguar? Ç'shkruan në atë mesazh? Nga kush?

Nuk dija si ta gjeja mënyrën për t'ia marrë telefonin. Dhe, në çast sajova një gjë: I thashë se mu duk që aty pari kaloi djali i dajës së tij. Ai pa një e pa dy u ngritë dhe u nis drejt derës. Doli jashtë dhe, siç më duhej mua, u vonua pak. Shpejt e shpejt ia hapa telefonin dhe e lexova mesazhin, të

cilin nuk kishte arritur ta fshinte, meqë do e dinte se diçka fshihte prej meje. Dhe, e keqja ishte se dikush kërkonte të pinin kafe bashkë. Nuk e kishte shkruar emrin në fund të mesazhit, por i thoshte se ti e di fort mirë se kush jam. U nevrikosa, u bëra si e marrë...

Kur u kthye nuk u përmbajta dhe troç i thash: Ta lexova mesazhin! Kush ta ka shkruar? Ai u skuq në fytyrë dhe kjo bëri ta kuptoja se diçka fshihte prej meje. Dhe, që nga ajo kohë më nuk i besoj edhe atëherë kur i dashuri im m'i jep mesazhet që i ka në telefon t'i lexoj. E kam humbur besimin në të.

Por, e keqja është se e dua shumë, madje si e marrë dhe s'po kam kah t'ia mbaj...

PËRFUNDIMI

Ka kohë që telefonat celularë janë bërë pjesë e pandashme e jetës sonë, por edhe mjet që përçanë, që jep mundësi për grindje.

Sidoqoftë, telefoni celular është mjet që na nevojitet në jetën e përditshme, por duhet ta dinë të gjithë se është edhe pjesë e privatësisë sonë.

Diturie Haxhaj



Mirë se vini mërgimtarë!



+385 49 50 90 90

[f](#) [i](#) [g](#) [www.cimaks.com](#)



Me bashkatdhetarët tanë...

Të vishë në Kosovë nuk është shëtitje, është dashni!

Shkruan: Arben Gjinaj

tur sëmuret dhe vetëm pas pak ditësh ndërroi jetë.

Se porosia e Fran Tanushit është thellë e ngulitur në mendjen dhe zemrën e secilit mërgimtar, kjo vërehet më së miri me përgatitjet e mërgimtarëve, të cilët, me muaj rezervojnë kohën e pushimeve, veçanërisht pushimet verore. Dhe, për dallim prej dy vjetëve të kaluar, kur mërgimtarët, si pasojë e pandemisë, përballeshin me ndalesa dhe masa të ndryshme, këtë vit thuajse nuk ka masa fare dhe fluksi i mërgimtarëve është shumë i madh.

Pavarësisht krizës ekonomike nëpër të cilën po kalon bota dhe rritjes së çmimeve në të gjitha sferat jetësore, pavarësisht mijëra kilometrave që kalojnë dhe pritjeve të gjata nëpër kufij, bash-

katdhetarët tanë si destinacion kryesor e kanë vetëm një rrugë – atë drejt vendlindjes.

Ata edhe sivjet kanë zgjedhur që pushimet verore t'i kalojnë në shtëpitë e tyre, me familjarët e tyre...

Por, jo vetëm për të pushuar.

Mërgimtarët, me këtë rrugë, sjellin në vendlindje edhe kursimet e tyre, duke i shpenzuar në dasma, ahengje, në ndërtim të shtëpive, biznese etj.

E, pavarësisht se si do t'ju presin në vendlindje, pavarësisht fjalëve nënçmuese që mund t'ua thonë, ju vazhdoni të shkoni në atdhe, sepse aty është shtëpia juaj, është familja juaj, është vendi juaj, ashtu siç na la amanet poeti Fran Tanushi se vendlindja nuk është shëtitje, por është dashni.

"Të shkosh në vendlindje nuk është shëtitje, është dashni", kështu kishte shkruar vitin e kaluar poeti nga Gjakova, Fran Tanushi, disa ditë para se të kalonte në amshim.

Për shkak të rrethanave të asaj kohe, Tanushi, si student detyrohet të marrë rrugët e mërgimit. Ai vendoset në Augsburg të Gjermanisë. Ndonëse për vite të tëra jetoj në mërgim, mendjen dhe zemrën e kishte gjithmonë tek atdheu... Këtë na dëshmojnë poezitë e tij të shumta kushtuar mallit për tokën dhe vendin ku u lind dhe u rritë, si dhe pjesëmarrjet në orët e shumta letrare nëpër Evropë dhe anembanë trojeve shqiptare.

Në gusht të vitit 2021, Fran Tanushi, ishte kthyer nga Gjermania për pushim në Kosovë, por papri-


Pse ishte enciklopedi kombëtare Xhemail Abria?

Xhemail Abria (1830-1908) është enciklopedi e urtisë popullore dhe kombëtare. Ai tërë jetën ia kushtoi pajtimit dhe pleqërimit në odat e burrave të kohës. Kishte marrë pjesë edhe në tubime kombëtare për luftëra, shpëtim të popullit dhe liri. Ai ishte edhe parashikues, sepse thoshte se do të shkojë, të paktën, edhe një shekull që ky popull të merr trajtën kombëtare. Parashikimet e tij kanë dalë të sakta në shumë raste...

Skaj rrugës së asfaltuar në fshatin Abri e Epërme të Drenicës qëndron krenare një kullë, që ka pritur dhe përcjellë shumë pushtete dhe pushtues.

Kulla tradicionale shqiptare, e para gati dy shekujve, tani së voni e riparuar, e kthen njeriun me shekuj prapa, në kohën kur oda ishte gjyqi i popullit dhe kur mençuria popullore ishte e çmuar sa edhe buka.

Aty pranë kullës nuk duket vetëm lisi i madh nën të cilin tuboheshin burrat e mëdhenj, para se të merrnin rrugën për pleqërim, e ku i pari i pleqërisë së Kosovës, e më gjerë në trojet shqiptare, fliste duke u thënë të pranishmëve se nuk mund të merrnin me vete lakminë kur të shkonin të pleqëronin, sepse lakmia dhe ple-



qërimi nuk shkonjë së bashku. Në trashëgiminë familjare të Xhemajl Abrisë, aktualisht stërnipi, Vesel Xhemajli, ndjek rrugën e të parit të shtëpisë së Xhamajl Abrisë, i përfshirë në akte të ndryshme pajtimi e gjykimi, për të gjitha rastet që i janë besuar t'i lihen në dorë atij dhe odës së pleqërimit, si një gjyq popullor i kodit të Kanunit të Lekë Dukagjinit. "Tradita e odës së Drenicës, por edhe më gjerë, nuk është zhdukur, përkundrazi vazhdon me ritëm shumë dinamik.

Njerëzit vazhdojnë t'u besojnë burrave të besës e të fjalës dhe drejtësisë popullore, që është forumi më

i besueshëm për vendime të drejta", nisë rrëfimin Veseli.

Veseli është në ngjarje sa i përket pranisë së rrjeteve sociale, që po bëhen gjithnjë e më virale në popull, veçmas te brezi i ri, që është e ardhmja, prandaj ai e di se shumëçka ka ndryshuar dhe po ndryshon çdo ditë e më shumë.

Ai sjell edhe kritikën e veta rreth pasojave të rrjeteve sociale, pas të cilave janë rritur pabesitë dhe ndarjet bashkëshortore, tema këto që më së shumti po kërkojnë trajtim në oda pajtimi sipas traditës.

"Xhemajl Abria, i njohur për mençurinë dhe inteligjencën e pazakontë, si

dhe mprehtësinë e gjykimit objektiv, ka dhënë kontribut të çmuar edhe për parashikimet e zhvillimeve kombëtare dhe ishte ftuar në të gjitha tubimet e nivelit kombëtar. Ishte i pa kompromis në luftimin e dukurive të vëllavrasjes dhe thoshte se kombi nuk ka liri derisa ekzistojnë vëllavrasjet brenda shqiptarisë... Xhemajl Abria e luftonte me tërë qenien e vet shpirtërore të keqen mes kombit, duke ditur se për t'u bërë komb i territorit sovran, duhet përrjashtuar dhe eliminuar shumë të këqija, të cilat, në fund, përfundonin para gjyqit të burrave.

XHEMAJL ABRINË E BËRI TË MADH NDARJA E DREJTËSISË

"Ajo që e ka bërë të madh Xhemajl Abrinë, si pleqnar i respektuar, e që i kishte kaluar kufijtë e Kosovës së sotme territoriale, duke marrë pjesë deri në Malësi të Madhe, ishte drejtësia", kështu e cilëson të parin e shtëpisë Vesel Xhemajli, në Abri. Abria ka luajtur rol të shumëfishtë në fushën e drejtësisë edhe për të drejtat e kombit që kërkonte daljen nga robëria otomane.

Pleqërimi ishte vetëm njëri ndër asetet e pasurisë shpirtërore e kombëtare që u lindën në Abri të Drenicës. Aty vihen idetë e para të themelimit të rezistencës kombëtare.

Dhe, duke treguar këtë historik, i cili është përcjellë në traditën e trashëgimisë familjare, ai thotë: "I pari i cili e kishte folur fjalën se Xhemajl Abria do të bëhej një i ditur nga dija, ka qenë pasha turk. Ai po kalonte pranë tij, teksa Xhemajli po i kullose lopët...

E pyet:

"A po të kullosin lopët?"

"Po, të miat janë!", ia kthen Xhemajli. Me këtë pashai e kishte kuptuar se ai nuk ishte bari i rëndomtë fshati, por ishte një djalë që i shërbente familjes.

Me të marrë përgjigjen pashai kishte thënë se ky fëmijë vlen të mbahet mend, pasi do të bëhej njeri i ditur. Xhemajl Abrinë e ka bërë të madh

drejtësia. Ai s'e donte gjykimin nën korrupsion. Ishte i drejtë dhe i përkryer në vendime...

"Nuk di që kam dëgjuar se nuk ia ka lidhur kokën ndonjë problemi, kudo që ka shkuar. Ju ka ndodhur shumë pleqnarëve të dështojnë në oda, por Xhemajl Abrisë kjo nuk i ka ndodhur kurrë...

E kanë marrë për pleqërim edhe jashtë Kosovës dhe pleqërimi i tij ka arritur edhe në Malësinë e Madhe. Në vitin 2008 i ka bërë 178 vjet nga lindja dhe 100 vjet qëkur ka vdekur. Në familjen tonë përcillet e dhëna se Xhemal Abria tërë jetën ia ka kushtuar pleqërimit, në shërbim të kombit dhe pajtimit, duke i ofruar njerëzit dhe duke i shëruar plagët e lëndimeve ndërfamiljare.

Shtëpia e tij ishte një kullë që po e shihni tash. Ka qenë me po këto përmasa dhe në po këtë vend ku është tani.

Ne e kemi riparuar, por kulla ka qenë në këtë vend. Këtu ka qenë një lis i madh, ku janë ulur, zakonisht, burrat para se të merrnin një udhëtim për pajtim e pleqërim.

Këtu, në këtë lëndinë, takohej Xhemajl Abria me grupin e vet të pleqërimit dhe, kur tuboheshin të gjithë, ai ua kujtonte atyre një realitet, përmes një anekdote:

"Oj e kajte (lakmi), a po rri ti këtu e ne po shkojmë, apo po shkon ti e ne po rrimë, se të dy nuk mund e s'kemi vend?! Na kanë thirr në një pajtim e ti s'un vjen me neve!"

Kjo ua bënte të qartë burrave se, nëse dikush ishte i korruptuar, nuk kishte vend me Xhemajl Abrinë.

Dhe, ai, pikërisht për këtë shkak, ishte bërë i lartësuar, i ngritur e i kërkuar, sepse nuk ishte korruptuar kurrë dhe e kishte kryer misionin e shenjtë në mënyrën më humane. Ai ka qenë i vetmi që ka pajtuar njerëz dhe që ka pajtuar edhe fise, duke u vënë kapakun punëve të rënda.

Pleqërimi ka qenë traditë e familjes sonë dhe ka funksionuar edhe para Xhemajl Abrisë, por ai i ka kaluar të gjithë pleqnarët e familjes sonë, e

që kanë pleqëruar edhe më herët", tregon Veseli.

ME CILËT MBIEMRA NJIHEJ

XHEMAJL ABRIA?

Xhemajl Abria ishte njohur në kohën e vet me tre mbiemra: Xhemajl Aga, Xhemajl Seferi dhe Xhemajl Abria. Vesel Xhemajli, duke i shpjeguar këta mbiemra, që më shumë ishin si epitete, thotë:

"Kur e kanë pyetur Xhemajlin pse po të quajnë Xhemajl Aga, ai kishte thënë se këtë mbiemër ia kishin vënë shkak se shumë njerëz i kishte drejtuar në rrugën e drejtë të jetës. Mbiemrin tjetër, Xhemajl Seferi, e kishte nga babai i tij, ndërsa me mbiemrin Abria njëhej në të gjitha rastet, më së shumti për nevojat mbarëshqiptare.

Xhemajl Abria i ka pasur dy fëmijë, djalin Bahtirin dhe vajzën Hamiden. Bahtiri, djali i tij, i kishte pesë djem dhe tri vajza. Babai im ishte djali më i madh i Bahtirit. E, Bahtiri kishte Isufin, Smailin, Veselin dhe Murselin. Xhemajli ka pleqëruar me një shok të mirë dhe korrekt, e ai ishte Shaban Kajtazi i Kijevës.

Ata e kanë pasur një ekip pajtimi, që, sipas natyrës së problemit, edhe janë dedikuar të shkojnë për vendime në oda, por Xhemajli nuk ka munguar kurrë...

Përveç moskorruptimit në pajtime, Xhemajl Abria e ka ngritur shumë edhe një njeri me ndikim me emrin Binak Alia, i cili, në një rast, i kishte thirrur edhe krerët e fiseve dhe Xhemajli, si më i riu që ishte në tubim, e kishte pasur rastin të prononcohej i fundit në tubim.

Binak Alia i kishte thënë se ti nuk fole fare, prandaj po ta japim fjalën...

Xhemajl Abria kishte thënë në atë tubim: "Derisa ne ia kthejmë pushkën njëri-tjetrit, nuk kemi çka tubohemi!". Prej aty e ka marrë hovin e madh, sepse Binak Alia ia ka dhënë krahun si dijetar, që nuk mbahej mend këndeji pari dhe ka thënë se ky është i ditur dhe mund të luajë rol dominant me mençuri për vendime të mëdha kombëtare...

Herën e dytë që e ka arritur madhësinë e vet ka qenë Juniku.

Një pajtim i madh i gjaqeve, që ka ndodhur, kryesisht, me ndikimin e tij, i ka dhënë atij tiparin e një burri të urtë, i cili do të bëhej njeriu më i kërkuar i kohës së tij, që ka jetuar mes viteve 1830-1905.

Ai i ka dhënë nam të madh pajtimit në tërë kombin. Aty ku nuk ka mundur të kryente punë askush, ka kryer punë Xhemajl Abria!

Shumë këso pajtimesh, ku ka kryer punë mençuria, mjerisht nuk janë përcjellë me shënime dhe kjo që ne sot dimë për Xhemajl Abrinë është diçka që vetëm është përcjellë brez pas brezi”, thotë Veseli.

XHEMAJL ABRIA E PËRDORI ADN-në I PARI!

Xhemajl Abria tërë jetën ia kushtoi pajtimit dhe ofrimit të të hasmuarve. Tërë jetën ofroi njerëz, duke i bërë miq nga armiqësia, por më shumë se kaq ai brengë e kishte kombin. Kishte raste që ndokujt nuk i pëlqente kur pleqëronte, apo kur fliste, por ai e çmonte vetëm drejtësinë.

Dhe, duke e shpjeguar një rast tepër të ndjeshëm, që është ruajtur brez pas brezi në sofrën e trashëgimisë familjare, Vesel Xhemajli e tregon ngjarjen ashtu siç ka ndodhur:

“Kishte ardhur nga Istogu Rexhë Hyseni, për të kërkuar ndihmën e Xhemajl Abrisë.

E ai, pasi e pranon në odë, i thotë: “Ulu e rrimë, pusho dhe bëjmë muhabet!”.

Ai ia kthen:

“Jo, nuk mund të buj!”.

“A mos ke ardhur me duqi të lagët, se nëse ke ardhur ashtu mulliri zor me i blu?!” i thotë.

Ai e kuptoi dhe ia kthen: “Ku po e di se jam me hall të madh?! I kam lënë në besë tri kabile, e vetëm deri të kthehem kanë besë të mos vriten! Kanë probleme me pronë dhe nuk po mund ta definojnë në asnjë mënyrë, andaj na duhet ndihma jote!”.



Xhemajli, pasi e dëgjoi, i tha Rexhës: “A e di ku është varri i fundit i kabiles?”.

“Çka të duhet varri, o Xhemajl?!”.

Xhemajli i thotë: “Me marrë një asht të atij varri dhe me e pastrua mirë dhe me marr gjakun e tri kabileve dhe me e qit në ashtin e varrit. Ai gjak që i kapet më së miri ashtit, prona është më afër tij”.

Dhe, mu ai veprim e kishte zgjidhur problemin...

Vlerat e vërteta të Xhemajl Abrisë qëndrojnë te fakti se ai e mbronte të dobëtin. Me punën e vet në pleqërimi dhe në ndeja rasti, ai, me gjykimin e vet, krijoi bazën e shëndoshë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Pleqnari i Kosovës nga Abria e Drenicës ka pleqëruar me burra qysh nga mosha 25-vjeçare dhe në analet e të dhënave të punës së tij në këtë fushë humane dhe morale të kombit, nuk mbahet mend të ketë dështuar në ndonjë pleqërim, apo çka e kanë bërë pleqnarët tjerë më herët e më vonë ta kenë dënuar më shumë të dobëtin për të arritur suksesin...

Populli e kishte kuptuar me kohë se ku hynte Xhemajl Abria për të ndarë drejtësi, nuk kishte lojë me fuqinë

materiale të familjes.

Ai e njihte mirë materien e kodit kanunor të ndarjes së drejtësisë popullore, që ishte për kohën vetë gjyqi. Ai kryente punë pajtimi edhe atje ku kishin dështuar të gjithë deri atëherë...

Xhemajl Abria ka qenë burrë që çdo gjë e mendonte si do të dukej nesër. Nuk dihet të ketë ndodhur diçka e që nuk mendonte se të nesërmen nuk do të dëgjohej”.

Veseli e tregon një rast kur kishte ardhur në kullë një burrë nga Plluzhina dhe, pasi troket, kërkon takim me Xhemajlin, por kërkon takim te dera e kullës, me shpresë se problemi nuk do të dëgjohej...

Xhemajli e pyet:

“A është problem që dëgjohej nesër?”.

“Po, se ka të bëjë me gruan!”.

“Hyn të flasim se diçka që ndihet nesër nuk mund të fshihet sot!”.

Ai edhe në ditën e fundit të jetës, kur ishte pyetur si në shaka nga të afërmit e familjes nëse po ndihej i frikësuar për vdekjen, u thotë: “Po frikësohem se nuk di a kam mundur ta bëjë vendin e mirë për në botën tjetër, edhe pse kam punua për atje çdo ditë!”.

Safet Krivaça

OFERTA E KORRIKUT

20%
ZBRITJE

Vlen të **Premtën** dhe të **Shtunën**

30%
ZBRITJE

Vlen nga **e Diela** deri të **Enjtën**

Mëngjesi | SPA | Fitness



★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA

A ka në Prishtinë dashuri për një natë?

“Ishte ditë e rëndomtë. U takova me të në “Qafë”, në Prishtinë. Na pëlqeu muhabeti dhe së shpejti u gjetëm në shtrat. “Çfarë fatlumi jam!”, e solla në mendje, në atë moment. Ishte e bukur, sykaltër. Të nesërmen, kur u zgjova, ajo nuk ishte në shtratin tim. Dera ishte pak e hapur, kurse mbi tavolinë kishte lënë një letër: “Mos më kërkoni kur- rë!”, thotë Driloni, teksa kujton femrën shumë më të moshuar se ai...”

PSE BËJMË JETË TË SHFRENUAR?

E tërë ajo që përjetoi Driloni, student i Fakultetit Ekonomik në Prishtinë, në natën ndërmjet një e dy prillit të sivjetmë mund të rrumbullakësohet me një fjali të vetme: Dashuri për një natë. Ai, faktikisht, ra viktimë e epsheve, të mos themi është shfrytëzuar prej asaj, së cilës në fillim ia mësoi vetëm emrin

– Dita.

Pse?

Është e thjeshtë: në kohën tonë, kur mashkulli i afrohet femrës, atëherë pse të mos shfrytëzohet edhe një mashkull e jo vetëm femra! Ky rast, të cilin vetëm e mora si pretekst për këtë shkrim, nuk do të ishte edhe aq interesant sikur të ishte i vetmi. Në këtë rast, mashkulli shpërblehet me kënaqësi për shërbim që i bën femrës, e femra e gjen prenë e vet, ndonjëherë edhe duke paguar “viktimën”.

E, si realizohet diç e tillë?

Thjesht, zonja (mund të mos jetë edhe e tillë) ka nevojë për shfryrje epsheve edhe me dikë, pos me burrin, por frikësohet se do ta kuptojë rrethi. Nga shoqja e vet, si në shaka, kupton se një gjë e tillë edhe mund të realizohet.

Por, që të realizohet një gjë e tillë, duhet të dilet jashtë banesës, në ndonjë lokal, të njihesh me një person dhe pas njohjes duhet bindur atë që të ruajë sekretin.

Pastaj, sa herë ke mundësi shkon

në banesën e tij dhe kalon çastet e dëshiruara.

PSE FEMRA E DRILONIT NUK U KËNAQË VETËM ME NJË NATË?

Por, rasti i Drilonit nuk përmbyllët vetëm me një natë. Ajo pas pak ditësh kthehet po në të njëjtin lokal dhe e gjen sërish Drilonin dhe pas ndejës përfundon sërish në shtratin e tij. Dhe, jo vetëm një natë e dy, por me muaj të tërë, aq sa edhe dashurohet marrëzisht në të.

Dashuria e saj për Drilonin tash s’kishte fund, kështu që edhe ndahet nga burri vetëm e vetëm që të ishte me Drilonin, jo që të martohej me të, sepse ajo e dinte se Driloni nuk do të martohej me një femër që ishte e martuar, por që të kalonte sa më shumë çaste bashkë me të. Por, pas një viti ata u thyen keq ndërmjet veti dhe Driloni e braktisi njëherë e përgjithmonë. E, kush e ka radhën të shkurorëzohet nga burri që të jetë në krahët e Drilonit do e tregojë koha...

Diturie Haxhaj



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

BOOM

*Çka
u ndalon
familjarëve
Genta Ismaili?*

*Të famshmet tona
me pak
skandale...*

*Politikanët
kosovarë
me gjini
të ndryshuar*

Merita Gashi

*e "Botique by Merita",
nënë e pesë fëmijëve
dhe grua e suksesshme
në biznes*

Merita Gashi e “Botique by Merita”, nënë e pesë fëmijëve dhe grua e suksesshme në biznes

Merita Gashi është femër e zonja, e pashme dhe e suksesshme në biznes. Ajo e jeton bukur jetën e saj, është bashkëshorte dhe nënë e dedikuar e pesë fëmijëve, që për të janë si drita e syve.

Njihet për sharmin, stilin dhe, mbi të gjitha, për suksesin e butikut të saj të famshëm “Botique by Merita”.

“Botique by Merita” sjell brendet prestigjioze dhe kualitative të veshjeve për femra, si “Gizia”, “Ipekyol”, “Nocturne” etj. Të gjitha modele të veçanta dhe për femra me shije të rafinuara. Jo rastësisht te Merita në Pejë shkojnë për t’u furnizuar me gardërobë unike e ekstravagante thujse të gjitha femrat e estradës, televizionit dhe botës së artit në përgjithësi.



Kur i hyre botës së biznesit?

- Biznesi i kam hyrë para katër vitesh dhe deri më tani gjithçka ka ecur shumë mirë e suksesshëm, ashtu siç edhe kam dashur.

Na fol pak për butikun tënd të famshëm tashmë?

- “Botique by Merita” sjell brendet prestigjioze dhe kualitative të veshjeve për femra, si “Gizia”, “Ipekyol”, “Nocturne” etj. Të gjitha modele të veçanta dhe për femra me shije të rafinuara.

Cilat janë markat që gjenden te ju?

- Ka disa firma që gjenden në butikun tonë, duke filluar nga “Gizia”, “Ipekyol”, “Nocturne” etj. Shumë e rëndësishme është që të gjitha veshjet janë të veçanta, cilësore dhe normalisht të përzgjedhura me shumë shije.

Keni blerës nga e gjithë Kosova dhe kjo tregon për atë se sa i veçantë është spektri i veshjeve te ju. Kush e bën përzgjedhjen?

- Po, në “Botique by Merita” në Pejë, vijnë vajza e gra nga e gjithë Kosova për të përzgjedhur veshjet më të bukura dhe më unike.

Gjithmonë e gjejnë atë që e kërkojnë dhe ndahen më se të kënaqura. Përzgjedhjen e bëj unë dhe deri tani përherë ia kam qëlluar, fatmirësisht.

A ka persona të famshëm që vishen te ju?

- Po, ka shumë femra të famshme që vishen te ne. Gjithsesi, me gjithë respekt për VIP-at, unë i respektoj dhe përpiqem për më të mirën për të gjitha klientet.

Si vijnë çmimet?

- Ka veshje që kushtojnë më shtrenjtë dhe veshje me çmime mesatare.

Duhet pasur parasysh që gjërat e mira kushtojnë. Por, përgjithësisht janë çmime të përballueshme...

A shisni edhe online?

- Po, pasi ka shumë të interesuar për të blerë online. Duhet ecur me hapin e kohës edhe në këtë drejtim.

A mund të na flasësh pak për jetën tënde përtej biznesit?

- Jam femër e singertë, e dua punën dhe më pëlqen të jem aktive. Jam nënë e pesë fëmijëve, të cilët përditë më bëjnë krenare me sukseset e tyre.

Sigurisht, bashkëshortin e ke përherë krah?

- Bashkëshorti im është, gjithashtu, mjaft i angazhuar me punë dhe biznes, meqë që 35 vjet ka rrjetin e marketeve "Luani", shumë të famshme në Pejë dhe jashtë Kosovës.

Sa shpenzoni në pamjen e jashtme?

- Varet, herë më shumë e herë më pak. Neve, femrave në përgjithësi, na pëlqen të shpenzojmë, ama shpesh shuma e shpenzimeve varet nga disponimi.

Dukeni moderne. Cilat janë komentet që merri për veten?

- Jam bashkëkohore, andaj nuk më pëlqen ta teproj as me modernitet. Nuk dua të dalë jashtë normales. Përgjithësisht, më pëlqen thjeshtësia. Komente marr, kryesisht, për sinjeritetin tim.

Kur e sheh veten në pasqyrë çfarë mendon?

- Them se dukem mirë.

Mesazhi yt për femrat?

- Të jenë sa më të forta për veten e tyre dhe të mos ndalen në rrugën e suksesit.

N. N.



Të famshmet tona me pak skandale...

Plazhet kanë marrë jetë nga pushuesit, e ekranet, faqet online, magazinat dhe rrjetet sociale, mbushen me imazhe elektrizuese të bukurosheve tona.

Këtë verë, veçanërisht, do ta shënojnë disa nga femrat shqiptare që kanë talent, por edhe duken shumë joshëse, e madje shumë bujare kur vjen fjala për të ekspozuar asetet trupore.

Disa kanë edhe "skandale"...

ORIOLA MARASHI

Po gëzon vëmendje në të katër stinët e vitit, por kjo verë, me sa duket, do të jetë me sytë kah bukuroshja nga Tirana, pamja e së cilës është tejet sensuale.

E bukur, e komentuar, e zjarhtë. Oriola është imazh i disa brendeve të njohura dhe nuk ndalet së ekspozuari linjat e saj me bikine.



ERA ISTREFI

E popullarizuar edhe përtej kufijve shqiptarë, e pëlqyer si gjithmonë, Era Istrefi po e ndezë edhe këtë verë. Ajo e ka dëshmuar se është ikonë e stilit dhe muzikës moderne e origjinale. Kjo verë po kalon nën hijen e imazheve të saj tejet joshëse dhe këngëve atraktive që po sjell.

Ajo nuk ka ndonjë skandal, ani pse ish-lidhja e saj shumë shpesh ka pushtuar mediet rozë.





ARTA NITAJ

Doli nga hiç, por tani konsiderohet si një nga femrat më të përfolura në vend. Pejania e bukur është kudo në mediet rozë.

Arta tashmë është një nga femrat që deshëm apo s'deshëm nuk kemi ku t'i ikim.

Ajo përflitet edhe për skandale, por çdo shkronjë që shkruhet për të e marketon më shumë.

ENCA HAXHIA

Nuk do mend që ajo do t'i përdor të gjitha "armët" për të pasur gjithë vëmendjen kah vetja. Të gjithë i njohin strategjitë e Encës për të përfituar sa më shumë terren mediatik, fansa në rrjete sociale dhe, gjithashtu, për ta mbizotëruar edhe më tej këtë pozitë që ka në tregun muzikor. Enca edhe këtë verë është mjaft provokuese...



ARTA ELEZAJ

E fundit, por jo më pak e rëndësishme në listën e femrave "hot", Arta Elezaj, modelja dhe ish-aktoria e "O sa mirë", tashmë është shndërruar në personazh të famshëm të shou-bizit dhe të gjithë po mrekullohen nga linjat e saj super të nxehta.

E, kush mund t'i rezistojë Artës, e cila, megjithatë, nuk ka kaluar pa u përfshirë në skandale!

N.

Politikanët kosovarë *me gjini të ndryshuar*







Behgjet Pacolli



Donika Kadaj - Bujupi



Melihate Termkolli



Milaim Zeka



Aplikacioni “FaceApp”

është bërë tejet i popullarizuar, duke mundësuar që njerëzit të arrijnë perfeksionin në pamjen e tyre, ani pse perfeksion i rrejtshëm. Ky aplikacion ka edhe mundësinë e ndryshimit të gjinisë.

Në “Boom” publikojmë disa nga politikanët kosovarë, pikërisht, në versionin e këtij aplikacioni që ndryshon gjininë.

A thua, këta politikanë a do ta kishin suksesin dhe impaktin e njëjtë në skenën politike kosovare nëse do të ishin të gjinisë së kundërt?



Çka u ndalon familjarëve Genta Ismaili?

Më nuk është aktive si dikur, pasi është bërë nënë dhe impenjimi i saj kryesor është për dy fëmijët e saj binjakë. Ndonëse jo më prezent si dikur, për gjërat rreth muzikës dhe shou-bizit, ajo mendon njëjtë. Për këto dhe të tjera, veç në “Boom”...

A është e rëndësishme për ty se sa shikime i merr një video e jotja në “Youtube”?

- Edhe kjo gjë e ka rëndësinë e vet. Por, jo gjithmonë projektet e arrijnë atë që e meritojnë. Shifrat nuk janë vendimtare për suksesin e një projekti muzikor.

Po, komentet çfarë rëndësie kanë për ty?

- Sigurisht që e kanë rëndësinë e vet, sepse secili këngëtar bën diçka për t'u komentuar. Të gjithë duan të dëgjojnë komente pozitive, por jo gjithmonë janë të tilla. Komentet na ndihmojnë ta dimë se ku jemi, çfarë po pëlqehet e çfarë jo, ndonëse shijet janë të ndryshme.

Për ty gjithmonë ka thashetheme...

- Thashethemet nuk ndalen asnjëherë. Para

pak kohësh thanë se jam trashë. Nuk ka problem, le të flitet.

Nganjëherë fjalët që thuhet poshtë e lart na bëjnë më të kujdesshëm, më të vëmendshëm e më të përgjegjshëm.

A të bëjnë përshtypje thashethemet?

- Para disa kohësh u kam thënë familjes dhe shoqërisë që të mos më tregojnë asgjë çfarë lexojnë. Mua nuk ma ndjen çka thuhet, kështu që nuk dua të dëgjoj asgjë çfarë flitet apo shkruhet. Unë e di se çka bëj e si jam, e kjo ka rëndësi.

A është e rëndësishme pamja e jashtme për ty?

- Si për çdo femër tjetër, edhe për mua pamja e jashtme e ka rëndësinë e vet. Kujdesem që të dukem mirë, sepse skena kërkon edhe bukuri.

N. Neziri

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Në kontaktoni në Info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de



Çka po ndodh me ne?

Halla ime i kishte 10 fëmijë, unë mezi 1!

Halla ime ishte grua me shami në kokë. Ajo e mbante gojën mbyllur me fasulet kur kalonin burrat përballë saj. Ishte grua që nuk dinte shkrim-lexim, por që i donte shumë fëmijët për hir të Kosovës dhe luftës që do të ndodhte, pa dyshim.

PSE HALLA, SA HERË VINTE TE NE, E SILLTE NGJA NJË PULË?

Halla ishte më e dashura e shtëpisë sonë. Ajo i kalonte tri e më shumë orë arave teksa arrinte te ne, në shtëpinë tonë. Kur ia kishte marrë kooperativa gjyshit tonë tokën, e që ajo tokë kishte qenë shumë e madhe, e kishin lënë një udhë këmbësore që shpinte në shtëpinë tonë.

Dhe, ajo rrugë më së shumti shfrytëzohej nga halla. Toka e kooperativës dukej si në shuplakë dore nga shtëpia jonë dhe ne, fëmijët, shpesh shikonim andej, në shenjë të kureshtjes dhe mallit për ta parë hallën kah vinte...

Kush e shihte hallën i pari konsiderohej më i shkathëti...

Ajo, në njërën e herëve, erdhi me një pulë nën krah. Këmbët ia kishte lidhur pulës, në mënyrë që të mos i ikte rrugës... Atë pulë e di se e mbajtëm një kohë të gjatë, derisa edhe u plak. E quanim "pula e hallës".

Dhe, sa herë që e përcillnim hallën, ne, fëmijët, e pyesnim kur do vinte

përsëri...

Nuk ishte halla vetëm një grua me shami në kokë. Nuk ishte vetëm grua që e mbyllte gojën me fasulet kur kalonte pranë burrave të huaj. Halla ishte shumë më shumë se kaq...

Ajo nuk dinte të sillte vetëm pulë me këmbë të lidhura në shtëpinë ku ishte rritur, por ishte edhe një patriote.

Po qëndronim ulur nën hijen e bagremit. Një mal me bagrem sa shihnin sytë. Ishte fillimi i qershorit. Nga larg shihej teksa vinte një grua me tre fëmijë. Kur arriti te shtëpia jonë, halla nga larg e njohu.

"U bë mirë, motër, që u pamë", i tha hallës.

Në bisedë e sipër halla e pyeti:

"Sa fëmijë i ke?"

"I kam gjashtë fëmijë", tha ajo.

"Sa vjeç e ke më të voglin?"

"Më i vogli është pesë vjeç".

"Pse i ke ndalur lindjet?"

"Nuk po mund të lind më, se unë nuk i kam ndalë!"

"Shko te hoxha i Gadimes dhe të shkruan, se qenke ende e re t'i lësh lindjet!"

"I kam gjashtë fëmijë, shyqyr Zotit,

janë mjaft. Nuk po kam mundësi me i mbajt si duhet, se kohë skamjeje është".

"Por, ti duhet ta dish se për inati të Serbisë duhet të lindim sa më shumë! Serbinë mund ta mposhtim vetëm duke bërë shumë fëmijë. Unë i kam dhjetë.

Por, jemi mbetur pak njerëz si familje, sepse 17 prej familjes sonë kanë shkuar në Turqi dhe më nuk i kemi parë kurrë. Kështu po tretim e Serbia po bëhet më e fortë se ne. Nëse nuk bëjmë shumë fëmijë, Serbia do na gëlltisë...", i dha halla vulë këtij muhabeti.

ÇKA I DUHESHIN HALLËS 10 FËMIJË?

Kjo gjë tash më zgjon kureshtjen se halla, edhe në atë kohë, e njihte mirë Serbinë...

Dhe, koha tregoi se kishte pasur të drejtë kur thoshte gratë të lindin sa më shumë fëmijë, në mënyrë që ta çlironin Kosovën nga Serbia, ashtu siç edhe ndodhi...

S. K.





Si e njoha tim bir pas 20 vjetësh!

Sonte, si kurrë më parë, e shoqëruar me tingujt e lehtë të një kënge që pasqyron dashurinë e singertë, e cila ishte hit në kohë të dikurshme, mallëngjehem me ditët, muajt e vuajtjet që ikën, e që lanë pra pa plagë të pashlyeshme...

Ishte koha kur shumë pak të reja kishin mundësi të shkolloheshin. Ishin vitet 80, kur gjendja ishte jostabile në Kosovë, e shumë të reja nuk kishin mundësi të shkolloheshin, nga se kushtet ekonomike ishin shumë të rënda, shumë të tjera ndiheshin të rrezikuara, nga se çdo gjë ishte nën monitorimin e forcave serbe. Një pjesë tjetër, e një shtrese që i takonin, kryesisht, shtresës rurale, nuk kishin mundësi të shkolloheshin, nga se mentaliteti i atëhershëm i njerëzve refuzonte në çdo kontekst shkollimin, sidomos të femrave. Unë, edhe pse vija nga një fshat i largët, vendosa t'i vazhdoja studimet,

nga se kisha përkrahjen e familjes. Dhe, pas regjistrimit në fakultet, u vendosa në konvikt. Pengesë të vetme e shihja se në atë kohë konviktet ishin të përbashkët për të dy gjinitë, gjë që e shqetësonte shumë familjen time. Por, edhe këtë pengesë e tejkaluam, duke pasur parasysh karakterin çfarë kisha unë. Aty nisa të shoqërohesha me Albanën, e që ishte e anës sime... Dhe, shpejt u bëmë shoqe të mira dhe të pandashme. Sepse, të dyja studi-onim juridikun. Sidoqoftë, çdo mbrëmje dilnim në oborrin e madh të konviktit, e ku kishte vende për t'u ulur e biseduar. Dhe, si për çudi, gjithmonë hasnim

në dy djem, që, si duket, na përcillnin, meqë e kishin mësuar kohën kur dilnim në mbrëmje.

SI U NJOHA ME ELBASANIN?

Gati çdo ditë kur dilnim, takonim dy djem, të cilët na përcillnin vazhdimisht. Shpesh i takonim edhe në fakultet.

Kalonin ditët, kurse ne as që dinim kush ishin ata... Një mbrëmje, derisa ishim ulur pranë Konviktit numër 5, u afruan afër nesh dhe Albanës i kërkuan librin që e kishte në dorë. E, kjo ishte vetëm një arsye për t'u

ofruar, se qëllimi i tyre dihej – njohja me ne. U prezantuan: njëri quhej Valon e tjetri Elbasan.

E, pasi u prezantuan kërkuan të uleshin pranë nesh, sepse, sipas tyre, vetëm pranë nesh kishte vend të lirë për ulje.

Dhe, kaluam një orë të plotë në shoqëri të tyre, duke mos vërejtur fare se ora kishte shkelur 22-shin.

Mirëpo, pas atij takimi, si unë, ashtu edhe Albana, kishim filluar të oriento-heshim në një botë tjetër.

Mbrëmjeve më nuk flisnim për atë se çka duhej të mësonim, por kryekëput flisnim për ndjenjat tona që kishin filluar të rriteshin për ta...

Kështu, pas nja një jave a më shumë, takimet tona me Valonin e Elbasanin sa vinin e shtoheshin... Andaj, kalonim shumë mirë në shoqërinë e tyre, sa edhe në bibliotekë nisëm të shkonim bashkë. Dhe, në muajin e dytë të njohjes sonë, Albana e Valoni filluan lidhjen e tyre. U bën një çift që përshtateshin për gjithçka... E, kjo bëri që edhe raportet ndërmjet meje e Albanës të zbeheshin, sepse s'kishte kohë për të gjitha...

E unë, edhe pse çdo ditë dilja me Elbasanin, prioritet i kisha studimet, e të tjerat pas studimeve.

Elbasani ishte i gjatë, zeshkan, me pak mjekër, simpatik, e, mbi të gjitha, i sinqertë e i sjellshëm.

KUR MË PUTHI ELBASANI EDHE DIELLI PERËNDOI NDRYSHE!

Dhe, sa herë ishim bashkë na shoqëronte një këngë, që ishte hit i kohës, teksti i së cilës kishte një dashuri të pastër, të kthjelltë si loti... E, në njërën prej ditëve, teksa dëgjonim këngën tonë të dashur, mora puthjen e parë nga Elbasani.

E, atë ditë, nga emocionet, mu duk se edhe dielli, në muzgun e asaj mbrëmje, perëndoi ndryshe...

Dhe, për çudi, po atë mbrëmje Albana me Valonin kishin marrë vendim të fe-joheshin... Pra, ajo mbrëmje ishte me fat për ne, të dyja, sepse për të dyja jeta nisi të marrë kah krejt tjetër.

Të nesërmen u nisa për në shtëpi.

Por, gjatë rrugës më kaploi një mërzë, sepse më dukej sikur gjysmën e trupit tim e lashë në Prishtinë...

Dhe, pas dy ditësh u ktheva në

kryeqytet. E, po atë natë Elbasani më ftoi të flija në dhomën e tij, sepse ishte vetëm, cimerët nuk i kishte aty.

Kur shkova në dhomën e tij, i thashë se unë veç tregova në shtëpi për lidhjen tonë. E, ai më tha se ende nuk e kishte bërë një gjë të tillë, meqë, sipas tij, në familje i kishin disa probleme të vogla.

SI NDODHI AJO QË NUK DUHEJ TË NDODHTE?

Mirëpo atë natë, pavarësisht dëshirës sime, ndodhi diçka e veçantë: atë natë iu dorëzova Elbasanit me mish e trup.

E, atë që ndodhi në shtrat me të, të nesërmen Elbasani e konsideronte gabim të madh, edhe pse ai që i pari që insistoi!

Në javën e tretë pas asaj nate të fam-shme, nuk ndihesha mirë me shëndet. I tregova Elbasanit dhe ai më dërgoi te mjeku.

Mjeku, pas një kontrolli goxha të gjatë, ma bëri me dije se isha shtatzënë! E, unë gati u çmenda, sepse ne nuk ishim as të fejuar, madje!

E, kur u kthyem në konvikt, Elbasani më tha troç: Foshnja nuk guxon të lindet! Pastaj, më tregoi se familja e tij ka kohë që insistojnë ta fejojnë me një vajzë të njohshme në Perëndim.

Por, mua një mendje më thoshte se ajo ishte veç një gënjeshtër dhe hiq më shumë, sepse ai sikur nuk kishte pasur ndjenja të mjaftueshme ndaj meje...

Por, meqë nuk doja ta shkatërroja veten, pas disa ditësh i tregova nënës për hallin tim dhe i thashë se nuk dua ta marrim në qafë një krijesë të pafajshme.

Dhe, nga ajo ditë e lëshova konviktin dhe kurrë më s'e pash Elbasanin...

SI E LASHË FOSHNJËN E PORSALINDUR?

Nga mërzia e madhe fillova të humbja edhe në peshë. Por, askush veç familjes sime nuk e dinte se isha shtatzënë.

Dhe, në muajin e nëntë linda djalë. Ia lashë emrin Elbasan.

Të nesërmen, para spitalit më prisnin familjarët e mi. Pak më larg pash se ishte edhe Elbasani me një burrë, e që mund të ishte babai i tij. Kishin ardhur të ma merrnin foshnjën, në marrëveshje me prindërit e mi!

E, ai që momenti më i vështirë i përjetuar në jetë.

MARTESA E PARË ME NJERIUN QË NUK E DOJA

Pas një kohe iu ktheva provimeve dhe arrita të diplomoj, pastaj të zë edhe një vend pune. Në punë punoja me një djalë nga Maqedonia, Besnikun, i cili sillej shumë mirë me mua. Por, mua sjellja e tij e mirë nuk më bënte përshtypje, sepse zemrën e kisha të ndarë në dysh – vazhdimisht mendja më rrinte te djali.

Por, pas nja një muaji, Besniku, djaloshi nga Maqedonia, bashkë me dy burra kishin ardhur në familjen time për të kërkuar të fejojesh me të, madje pa ma bërë as me dije! Dhe, po atë javë edhe u fejuam... Një muaj më vonë edhe u martuam pa dasmë.

Pra, ky ishte fati im...

Mirëpo, pas disa muajsh martesë, pas pune, edhe pse punonim bashkë, Besniku gjente arsye të ndalej në qytet dhe kthehej bukur vonë. Me kohë filloi edhe t'më maltretonte... Për këtë tregova në familje dhe ata më thanë me kohë të ndaheshim... Ashtu edhe ndodhi. Më pastaj, e ndër-rova vendin e punës, qëllimisht që të mos punoja me ish-burrin tim.

Në vendin e ri të punës punoja me një grua paksa në moshë, e cila e kishte ditur historinë e jetës sime dhe foshnjën që e kam lënë. Më tha se disa herë e ka parë fëmijën tim dhe ai po rritej vazhdimisht në duart e gjyshes së tij.

TAKIMI ME DJALIN PAS 20 VJETËSH!

Dhe, ditët, muajt, vitet e dekadat ecnin. Më nuk u martova, por iu përkushtova punës, sepse vetëm me punë e "mbysja" mërzinë.

Dhe, një ditë, pas sa e sa vitesh, ndodhi një mrekulli në jetën time, e që ishte e vetmja deri atëherë. Një të shtunë, pas përfundimit të punës, pash se një djalë, rreth të 20-ave më shikonte nga larg. Nuk e kisha parë kurrë në jetë, por disi më ngjasonte mua.

Kur kalova pranë tij, pasi më rroku për krahu, më tha: "Më puth, nëna ime!"

P. B.

Sa herë më kujtohet hyqmeti më rrëqethet trupi!

Në kohën e fëmijërisë sime oda jonë ishte e madhe, ndër më të mëdhatë në katund. Gjatë kohës së dimrit te ne vinin shumë mysafirë, aq sa rrallë ndodhte të kalonte ndonjë natë pa pasur dikë.

Pasdarke, të pranishmit në odë, rëndom, pinin çaj. Dhe, bashkë me çaj tregoheshin edhe ndodhi të ndryshme për kreshnikët, por shpesh ndonjë djalë i ri edhe ia mernte ndonjë këngë patriotike.

Por, kishte edhe net që ndryshonin krejtësisht nga të tjerat: në odë luhej "loja e kapuçave".

Burrat ndaheshin në dy grupe dhe njëri nga grupi e fshihte kokrrën e misrit nën njërin nga dhjetë kapuçat, kurse të tjerët ishin bosh. Duhej qëlluar se në cilin kapuç ndodhej kokrra e fshehur e misrit.

Grupi që fitonte, pastaj, ngrihej në këmbë dhe këndonte këngë që përqeshnin grupin tjetër, ndonjëherë edhe me ndonjë fjalë banale, por duke eliminuar ofendimet...

PSE KËNAQESHA ME "LOJËN E KAPUÇAVE"?

Si fëmijë kisha ëndjen t'i shikoj burrat kah loznin "lojën e kapuçave". Vetëm dy fjalë përdorshin gjatë lojës: "teste" dhe "bosh". Fjala teste flitej në shenjë se nën atë plis ndodhej kokrra, ndërsa bosh se nuk ishte aty.

Por, edhe aty kishte mjeshtri. Ai që e fshihte kokrrën, qëllimisht, e mbante shikimin kah një plis, kinse aty ishte kokrra. Por, ajo ishte vetëm një dredhi dhe asgjë më shumë, sepse kokrra ndodhej krejt diku tjetër...

Dhe, me të mbaruar loja ekipi fitues ngri-



hej në këmbë për të kënduar këngë për ekipin tjetër.

Xha Bajrami, mbaj mend, e mbante për krahu xha Limanin dhe, teksa këndonin, ia afronin këmbët te mustakët një burri në odë, i cili ndodhej në grupin e humbësve. "Çka je shtri burrë me një anë, bash si thiu në tërshanë?!"

Por, rregullat e lojës ishin që askush të mos hidhërohej, sepse pas përfundimit të lojës sërisht bëheshin bashkë dhe vazhdonin muhabetin për ngjarje e ndodhi të tjera...

PSE SILLESHIN KEQ ME POPULL NJERËZIT E HYQMETIT?

Një qerre druri me qe në zgjedhë kishte mbetur në baltën e rrugës së fshatit tim, pasi që njëra rrotë ishte thyer. Pranë qerres ishte një kanal balte, ku vështirë kalohej matanë. Përpara qerres qëndronte një djalë i ri, e që dridhej nga acari i dimrit. Malësori i gJORë kishte sjellë dru nga një fshat malor në fshatin tim për t'i shitur, e që me paratë e fituara do blinte miell dhe gjëra të tjera për shtëpi.

Babai im e solli djalin e ri brenda në shtëpi që të ngrohej. I tha nënës sime t'i jepte edhe bukë, ndërsa vetë doli ta ndihmonte malësorin.

Ndërkohë, aty pari kalon një veturë "Fiat 1300", e që në të ishin tre burra, mesap

zyrtarë shteti. Njëri prej tyre e uli xhamin e dritares dhe i bërtiti drushitësit:

"Largoje atë qerre nga rruga! A s'po e sheh që po na pengon të kalojmë, a?!"

Malësori deshi t'i tregonte si e kishte punën, por ai që foli e mbylli xhamin dhe nuk i interesonte se çka do i thoshte.

Babai im iu ofrua veturës së hyqmetit dhe i tha shoferit:

"Kini mëshirë për të gjorin! I është thyer rrota e qerres. Për këtë edhe dola t'i ndihmoj".

Shoferi hapi derën e veturës dhe, në vend se të kishte mirëkuptim, edhe ai filloi të krekosej. Në ato çaste babai im u nevrikos dhe mori një dru nga qerrja dhe u nis kah vetura e hyqmetit.

Por, shoferi shpejt e shpejt e mbylli xhamin e veturës dhe më nuk nxori zë nga goja...

Të nesërmen, në dyert e oborrit, u dëgjua një krismë. Dikush u binte me të madhe...

Dhe, ajo kërcitje nuk i pëlqeu babait. Tha se kur dyert kërcasin fort, janë hyqmeti.

Dhe, ashtu ndodhi. Dy policë e morën babanë dhe e futën në xhipin e policisë. Xhipi u nis e ne, fëmijët, mbetëm duke qarë...

Por, pasdite, kur ende dielli kishte kohë për të perënduar, babai u kthye në shtëpi. Tha se nuk e kishin rrahur, por e kishin kërcënuar që herëve të tjera të di si të sillej me njerëzit e hyqmetit...

S. Murturi



Adresa: Rruga B. Kompleksi Royal C15/C16
10000 Prishtinë - Kosovë

Kontakti: 038 746 922 / 049 641 000
Email: fortesabb@hotmail.com

Në Kosovë nusja më e keqe kushton 10 mijë euro!

Teksa pija kafe në platonë e restorantit afër Redaksisë, një kolonë veturash me flamuj e def kaluan afër nesh. Disa vajza të reja i kishin hapur dritaret e veturave dhe pjesën më të madhe të trupit e kishin nxjerrë jashtë. E, kënaqësinë e dasmave në Kosovë sot po e përjetojnë vetëm femrat. S'ka më traditë: burrat para e gratë pas...

Tradita e dasmës në Kosovë sot nuk trashëgon asgjë nga e kaluara. Askujt më nuk i intereson nëse nusja sot e ka të parin a të dhjetin mashkull për burrë...

A ka ecur rrugëve me kërthizë të zbuluar apo ka kaluar nga lokali në lokal...

TASH ÇDO DITË ËSHTË E DIEL PËR DASMA!

Sot çdo ditë është e diel për dasma. Dasmë prej të hënës e deri në të dielën... Se në cilën ditë bëhet dasma, më nuk i bën përshtypje askujt, sepse edhe shqiptarët e Kosovës e kanë kuptuar se secila ditë është e Zotit! Madje, ua kemi kaluar edhe evropianëve, të cilët edhe më tutje kanë mbetur me bindjen se dasmat duhet të bëhen vetëm gjatë vikendeve...

FEJESAT DIMRIT, MARTESAT VERËS...

Viteve të fundit vera është destinuar vetëm për dasma. Çdo ditë tollovi në

trafik me kolonë dasmash dhe sirena... E merrnin një nuse në Gadime të Lipjanit para do vitesh dhe disa të rinj, që shikonin anash teksa kalonte kolona e veturave, njëri nga ta thotë: "Po ta dinin këta se ç'nuse po marrin, nuk do u bënin sirenave!".

Por, sot kush ia vë veshin kësaj pune ma?!

10 MIJË EURO I BËHEN NUSES!

Manaja më e madhe e dasmës është kur "konferencierja", në lokalin ku organizohet dasma, merr mikrofonin në dorë dhe thotë: "Nuses iu bën dhuratë 10 mijë euro nga të pranishmit në sallë!".

Por, më e keqja është kur ajo fillon të thotë se nuses filani, nga Zvicra, i dhuron 500 euro; filani nga Gjermania - 200 euro; filani nga Prishtina - 20 euro, e kështu me radhë.

Në ato çaste njerëzit fillojnë ta shikojnë njëri-tjetrin dhe ndihen keq ata që

në zarfin e tyre kanë futur pak para, sepse më vonë do u përmendet emri edhe atyre...

E, ç'është më e keqja, pas martesës, çiftit të posa martuar i fillojnë edhe urimet në radiot lokale, e që njeriu has edhe në aso urimesh që të bëjnë të qeshësh, si, bie fjala: "Sa ka deti ujë e ranë, aq dashni pastë çifti i ri".

E, të mos flasim për dasmorët që shkojnë me e marrë nusen, sepse shumë vajza të reja edhe e rrezikojnë jetën e tyre, kur ulen mbi dritare të veturave, ose kur e nxjerrin pjesën më të madhe të trupit jashtë veture, të dala mendsh...

Dhe, të tillat sikur harrojnë se duhet jetuar edhe pas atij çasti të dasmës... Në anën tjetër, fatura e restorantit është mjaft e majme. Së paku 3000 euro paguhet këngëtari a këngëtarja, e mijëra të tjera për ushqim e gjëra të tjera.

Por, edhe pa u martuar nuk po bën...

Selim Rama



Boat Trip
Don't forget this summer!



 /canyonmatka_

TEL: +38970726265



Ku ta gjej një grua për qejfi?

Kishte shkuar një njeri i pasur në një fshat për të gjetur nuse për djalin e vet dhe si bazë të vlerësimit e kishte marrë një parim: ajo vajzë që kishte më së paku bërlllok në shtëpi do të bëhej nuse e djalit të tij.

Hyn në një shtëpi dhe e pyet një vajzë: "Po kërkoj bërlllok me mbledh!". E, ajo i kishte thënë se kishte sa të donte...

"Kah të kthehem e marrë!", ia kthen ai. Hyn në derën e dytë dhe njëjtë. E, kur hyn në derën e tretë, një vajzë i thotë se në shtëpinë e saj nuk ka bërlllok, sepse e pastron shtëpinë tri herë në ditë.

Andaj, mu ajo vajzë edhe bëhet nuse e të birit të tij.

PREMTIME SA TË DUASH, REALIZIM FARE!

Ky tregim i përgjigjet më së miri situatës së shtetit tonë, Republikës së Kosovës. Politikanë tanë abuzojnë me tenderë, vjedhin me të madhe. E, gjyqësia bëhet kinse nuk di gjë... Edhe partitë që financohen nga shteti luftojnë për të hipur në pushtet. Dhe,

derisa e marrin pushtetin e gënjejnë popullin për çdo gjë, kurse më pas popullin nuk e shohin katër vite me radhë!

Pra, në Republikën e Kosovës nuk gjen sende të mira e të mbara, si ajo vajza me pak bërlllok, por me bollëk gjen të këqija sa të duash...

Nëse merr shembull arsimin, s'ke si të mos marrësh shembull dallaveret që bëhen me rastin e pranimit të studentëve të rinj në fakultete. Nëse i pyeteni studentët absolventë se si janë regjistruar dikur, të tregojnë haptazi se janë regjistruar me intervenime.

Por, edhe sivjet, ditë më parë, në një emision televiziv, një prind ankohej se djali i tij nuk është pranuar në fakultetin e arteve, edhe pse vizatimet tij, që i tregonte para kamerave, ishin të mrekullueshme.

Ai thotë se janë bërë malverzime me kandidatët studentë.

ATA QË FLASIN, EDHE ABUZOJNË ME SHTETIN!

Dhe, ata që flasin e debatojnë çdo ditë për funksionimin e shtetit, mu ata më së shumti edhe abuzojnë me shtetin dhe mosfunksionimin e tij!

Prandaj, Kosova është vend i çudirave! Pata shikuar filmin "Shekulli madhështor". Para qindra vitesh, ai, sulltani i madhërishtëm, Sulejmani, ua hiqte kokat stafit perandorak nëse kapeshin në hajni apo në ndonjë lloj krimi ekonomik. Pra, e zbatonte ligjin edhe para 600 vitesh! E, tash, në shekullin XXI, ende politikanët tanë nuk marrin asnjë lloj përgjegjësie për asnjë shkelje ligjore! E çuditshme, a?!

Selim Rama



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Eh, jetë, jetë...

Nuk kam qenë e rehatshme, si të martohem tash?

Jetoj në Belgjikë. Qe tri javë jam në Kosovë. Sivjet kam ardhur me të vetmin qëllim: të gjej një frajer për t'u martuar. Në Prishtinë, edhe pse dikur isha e lindur këtu, shumë pak njerëz po i njoh, për të mos thënë fare. E, si do ia bëj me hallin tim?



Jam 27-vjeçare, bijë e një biznesmeni të njohur në Belgjikë. Kurrë familja ime nuk ka dashur që unë të martohem me një djalë të huaj, por me shqiptar. Por, ku ta gjej atë shqiptar tash, kur kam nevojë të martohem?

NUK ISHA E REHATSHME, ANDAJ EDHE PO PËSOJ!

Atje ku jetoj tash, thënë të drejtën, nuk kam qenë edhe aq e rehatshme. Si nxënëse, e më pas edhe si studente, prindërit nuk më kanë kufizuar në asgjë, kështu që shpeshherë jam vonuar deri në orët e vona me shokë e shoqe, e herë-herë edhe nuk jam kthyer fare në shtëpi. Por, ajo i takon së kaluarës... Tash kam ardhur në Prishtinë, në vendlindjen time, që ta gjej një mashkull për martesë, sepse koha po ecë e unë i kam bërë do vjet... Dëshira ime është të shëtisë sheshit

të Prishtinës, por, sado që nuk po ndalem, nuk po m'i ngul sytë askush. Ndoshta pse këtu, në Prishtinë, paska femra të reja e të bukura sa të duash. Madje, sa e shoh një femër të bukur, tjetra më duket edhe më e bukur. Sa e shoh një të re, tjetra më duket edhe më e re... E në mua veç kanë filluar të shfaqen rrudhat e para rreth qafës... Sidoqoftë, nuk dua të njihem me asnjë mashkull për aventura e as për seks, sepse këto gjëra nuk më kanë munguar në Belgjikë. Por, si ta gjej një mashkull që më përshtatet mua? Nga ai kërkoj vetëm të jetë i sinqertë dhe të më duaj kështu si jam, me të mirat dhe të këqijat që i kam... Pra, qëllimi im është të njihem me një mashkull për martesë dhe të krijoj familje me të, sepse këto dy gjëra, tash për tash, po më mungojnë.

NUK DUA T'MË DUAN MESHKUJT PËR INTERES!

Sidoqoftë, nuk dua të takohem me asnjë mashkull për interes, bie fjala, të më dojë sa për sy e faqe, që t'ia mundësojë një vizë hyrëse në Belgjikë, apo për pasurinë që ka babai im, me qëllim të ndonjë përfitimi pastaj. Megjithatë, jam e vendosur në një gjë: ata që gënjejnë kurrë nuk do të kenë vend në zemrën time, e sidomos ata që lavdërohen, që shesin mend se kanë pasur shumë vajza, por te asnjëra nuk e kanë gjetur veten... Asnjëherë nuk mund ta bindi veten të martohem me një mashkull në të cilin, së pari, nuk do të dashurohesha e tek pastaj të krijonim familje. Sepse, nuk është me rëndësi kush-kujt i ka propozuar njohje, por a e kanë gjetur atë që kërkojnë te tjetri. E, vetëm ai që mund t'më bëj të lumtur ka vend në jetën time.

V. S.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A po më tradhton burri?

Përshëndetje e nderuara magjistare, jam 43- vjeçare, jetoj në Prishtinë. Arsyeja që po të shkruaj është dyshimi se po më tradhton burri. Kurrë nuk kam menduar se do të ndodhë kjo dhe këtë dyshim e mbështes te fakti se para dy javësh ia pash në telefon disa foto intime. Unë po mendoj se ai po më tradhton me punëtoren e vet. A është kjo e vërtetë?

“E dëshpëruara”

Përgjigje:

Të drejtë dyshimi ke, por dyshimi nuk është argument mbi të cilin mund të veprosh, duke e thirrur dikë për të shprehur zemërimin tënd. Sikur ta kishe parë ti atë femër me burrin tënd në ndonjë mënyrë amorale, ajo e jep një kuptim dyshimi. Por, meqë e ka punëtore, normalisht që edhe fotografohen bashkë. Megjithatë, secila grua dyshon te burri i vet e jo vetëm ti, sepse ky është një ligj i pashkruar brenda të cilit nëse ne komentojmë i bie që burri dhe gruaja nuk janë miqtë më të dashur mes vete, por janë armiq të dashur, të cilët qesin kokën mbi të njëjtin jastëk, por kërkojnë ta kapin në flagrancë njëri – tjetrin.

Dua të them se ato foto në telefo-

nin e burrit mund të jenë një sinjal që te ti e zgjon kureshtjen për të hetuar më shumë rreth një lidhjeje të mundshme, por nuk të jep të drejtën për ta deklaruar një lidhje të mundshme.

Konkretisht, në pyetjen tuaj se a e ke të drejtën e dyshimit, unë mendoj se jo. Keni të drejtë të dyshoni, por nuk mund ta pohoni fajësim për atë femër.

Çfarë të bëj me të fejuarin që nuk e kam besnik?

Jam një vajzë, 23-vjeçare, e fejuar që dy vjet me një moshatar timin, të cilin e dua dhe më do, por mund të themi se që një vit më është zbehur dashuria për të, pasi e kam zënë kah më tradhton me disa femra dhe, kështu, kam rënë në dert.

Edhe para disa ditësh e zura përsëri me një rrjet social kah fliste me femra dhe gati erdhëm te ndarja, e unë besoj se ai rrezik nuk ka kaluar akoma.

Çfarë këshille më jep motër e dashur?

“Betimja”

Përgjigje:

Në këtë fazë të fejesës ku jeni ju sot, normale do të ishte që asnjërit prej jush as mendja të mos i shkojë për ndokënd tjetër, sepse nuk ka fazë më të lumtur në të cilën ju mund të

kaloni kohën pranë njëri-tjetrit. Por, nëse ai edhe gjatë kësaj faze të tradhton dhe merret me femrat tjera, unë nuk di çfarë nuk do të bëjë ai pasi të martoheni dhe të bashkoheni si bashkëshortë. Shtëpia e tij e di se nuk mund të ndikojë te ai që ta vetëdijesojë, prandaj në këso raste, zakonisht, është mirë të liroheni nga njëri-tjetri.

Kur i fejuari ngarend pas të tjerave, kuptimi është se me ty nuk është kah i shkojnë gjërat si duhet, sepse po t'i shkonin ai do të qëndronte vetëm pranë teje.

Kjo krizë shkon duke u thelluar mes jush dhe ky thellim mund të sjell sot a nesër probleme të tjera, e ato probleme nesër mund të të gjejnë ty si nënë apo si grua, e pasojat për ty dhe familjen do të jenë shumë më të rënda sesa sot ta marrësh një vendim për ndarje. Sot është çdo gjë me lehtë se nesër. Sikur të kishte ndodhur një herë, mund ta kishe falur, por duket se kjo gjë ka ndodhur te ai rregullisht dhe, më në fund, është bërë bajat, duke e falur ti e ai duke të tradhtuar.

Duhemi, por nuk mund të marthohemi!

Jam 31-vjeçare. Jam në lidhje me një person me të cilin duhemi shumë, por martesja jonë nuk është e mundur.

Ai, kohëve të fundit, po kërkon prej meje që të refuzojë çdo ofertë për fejesë, sepse po më thotë ka dëshirë të vendosë me mua, por unë nuk dua të pranojë një martesë të tillë, edhe pse nuk mund të mësohem pa të apo duke e pasur dikë tjetër. Çka të bëj, motër e dashur?

“Dy”

Përgjigje:

Ai është person i martuar dhe ka një fëmijë. Dhe, pa marrë para-

sysh dashurinë tuaj, ai e ka një grua të cilën e ka marrë me shumë dëshirë dhe është për ta ruajtur. Kur të kihen parasysh rrethanat mes jush dhe gjërat që ju rrethojnë, ti nuk ke asnjë arsye ta presësh tutje një burrë të martuar, i cili veç është në proces të mbylljes së kompletimit të familjes. Pra, nuk është korrekte që ti ta humbësh perspektivën dhe jetën, duke e prituri një burrë prej të cilit nuk pritet të kesh asgjë. Nëse lidhja juaj zgjat ende dhe nëse ndodh që ti të vendosësh të presësh atë sipas sugjerimit të tij, atëherë parashikoj që ai të hapë probleme me familjen e gruas, me familjen e vet dhe me gruan. Tërhiq nga kjo lidhje dhe gjeje fatin tënd, sepse nuk është vetëm ai mashkull në botë!

Pse i humbën ndjenjat burrit?

Jam grua, 36-vjeçare, kam fëmijë dhe jetoj jashtë vendit. Ka kohë që burri nuk ka ndjenja për mua. Jam munduar në shumë aspekte ta ofrojë pranë vetes, duke e ringjallur nga ana emocionale, por kot. Kemi biseduar herë pas herë për këtë problem dhe nuk e di arsyen pse ka ardhur te kjo situatë. Më është bërë bajat jeta me të dhe nuk di çka të bëj tutje. Kështu nuk jetohet, por çka të bëj, zonjë e nderuar?

“E brengosura”

Përgjigje:

Para së gjithash, duhet të dihet e vërteta pse ka ndodhur ky defekt. Nëse ndryshimi ka ndodhur për shkaqe shëndetësore, ti duhet ta pranosh jetën e tillë si bashkëshorte e tij besnike. Por, nëse ndryshimi te burri ka ndodhur për shkakun e aven-

turave të tij, e drejta jote për të zgjedhur një mënyrë jete, që të përshtatet, është legjitime.

Ky është një standard parimor, i përafërt edhe me kodin popullor dhe me atë shkencor e social, por unë shoh se ju asnjëri nuk keni jetuar besnikërisht në bashkëshortësi.

As ti nuk je në nivelin e ndjenjave për burrin e as ai për ty. Ky është treguesi më i saktë i gjendjes suaj. Andaj, nuk duhet ta prishni bashkëshortësinë, meqë asnjëri nuk jeni në rregull.

Ai e ka hetuar gjendjen tënde dhe ka ndryshuar negativisht për ndjenjë ndaj teje, prandaj duhet të bashkëbisedoni dhe ta harroni të kaluarën e afërt që ju ka bezdisur në deharmonizimin bashkëshortor.

Jam i bindur se kam magji!

E dashura magjistare, unë, që po u shkruaj, jam një djalë, 28-vjeçar. Ka gati 2 vjet që jam martuar dhe jam shumë në hall, sepse prej kur u martova mori gjithçka mbrapsht: grindje në familjen time, por edhe me bashkëshorten!

Akoma nuk kemi fëmijë. Jemi munduar që të kemi, por pa rezultate.

Çdo derë imja është mbyllur, nuk më del kysmeti as për punë... Me pak fjalë, çdo gjë në lidhje me jetën time është mbrapshtë.

Ju lutem, më bëni një zgjidhje, sepse jam i bindur se kam magji...

“Eduarti”

Përgjigje:

Ti ke hyrë në jetën bashkëshortore pa bazë materiale e financiare për jetë me gruan. Martesa sjell ndryshime në gjendjen shpirtërore dhe sociale me çka ndryshojnë edhe

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

rrethanat e të jetuarit, por aq më keq kur je në bashkësi familjare, që do të thotë të hash bukën që sigurojnë të tjerët.

Nuk është punë magjie këtu, por punë e ndryshimeve që ka sjellë martesa jote.

E, po të kishit pasur fëmijë do të ishte zhurma edhe më e madhe, sepse fëmija kërkon obligime...

Ta nxjerrë në dritë tradhtinë e burrit, apo të heshtë?

Përsëndetje, jam grua e re, nënë që shtatë muaj. Kam problem me burrë, i cili kuptova se është në lidhje me një grua të martuar.

Meqë kam jetë të mirë dhe më duan e tërë familja e tij, nuk di a të nxjerrë në shesh këtë tradhti të burrit, apo t’ia lë kohës?

Të lutem, më jep një këshillë?

“E tradhtuara”

Përgjigje:

Nuk të kisha sugjeruar ta bësh të madhe këtë problem. Të kisha sugjeruar të flasësh vetëm me burrë, e jo ta mbushësh shtëpinë me lajm të keq, i cili do ta bëjë burrin tërë jetën ta ulë kokën në familje.

Jeta i ka peripecitë e veta, i ka edhe sfidat të cilat duhet pasur durim për zgjidhje.

Megjithatë, ai nuk do të ta pranojë atë lidhje, por do ta mohojë kategorikisht, duke u thirr në faktin se janë kolegë pune dhe, thjesht, edhe ti do ta pranosh këtë fakt. Prandaj, fol me të. Nëse ke fakte prezantosa vetëm atij dhe mbaje lajmin në mes teje dhe burrit!

ULCINJ *condo*



*Lovely Condo Minutes
Away from the Beach*

www.airbnb.com/h/ulcinj-getaway



ulcinj_condo

Pse e shitën prindërit e Fifit arin që e kishin?

Prindërit bëjnë gjithmonë sakrificat më të mëdha për fëmijët e tyre. E, në këtë aspekt, nuk bëjnë përjashtim as prindërit e Fifit.

Prindërit e saj kanë bërë gjithçka që asaj të mos i mungojë asgjë, madje e kanë shitur edhe arin që e kanë pasur, që t'i krijojnë kushte Fifit.

"Që nga moshë 6-7 vjeç e deri në 22vjeç, me qenë të gjithë me vaxhe në dorë është shumë e rëndë psikologjikisht.

Për këtë arsye unë ia di rëndësinë çdo gjëje edhe më të vogël. Dua pak, por e dua me nder.

Për këtë arsye çdo njeri që nuk ka e respektoj më shumë se një njeri që ka. Ata që kanë nuk i vlerësojnë gjërat që kanë, ndërsa ata që nuk i kanë ia dinë vlerën.

Jam njeri që kam dashur gjithmonë t'i bëj krenarë babin dhe nënën, e ishalla e kam arritur qëllimin! Sepse, ata e kanë shitur edhe arin që e kanë pasur për mua...", tha ditë më parë Fifi në një prononcim të saj.



SHERWOOD

Resorts and Hotels



**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA